

L I G J
Nr.7515, datë 1.10.1991

**PËR ANËTARËSINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË FONDIN MONETAR
NDËRKOMBËTAR, BANKËN NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIMIN DHE
ZHVILLIMIN, KORPORATËN FINANCIARE NDËRKOMBËTARE, SHOQATËN E
ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR, AGJENCINË E GARANTIMIT TË INVESTIMEVE
SHUMËPALËSHE DHE NË QENDRËN NDËRKOMBËTARE PËR ZGJIDHJEN E
KONFLIKTEVE NË IVENSTIMET**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Shqipërisë është e autorizuar këtu në emër të Republikës së Shqipërisë të pranojë anëtarësinë e Fondit Monetar Ndërkombëtar (që këtej e tutje do t'i referohemi Fondi), në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe zhvillim (që këtej e tutje do t'i referohemi "Banka") në Korporatën Financiare të Investimeve (që këtej e tutje do t'i referohemi "Korporata") në shoqatën Zhvillimit Ndërkombëtar (që këtej e tutje do t'i referohemi "Shoqata") dhe në Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (që këtej e tutje do t'i referohemi "Agjencia") duke pranuar nenet respektive të Marrëveshjes së Fondit Bankës, Korporatës dhe Shoqatës siç janë rregulluar dhe duke nënshkruar dhe ratifikuar konventën themeluese të Agjencisë, tekstet e të cilave jepen në anekset I, II, III, IV dhe V të këtij ligji dhe duke pranuar kushtet dhe afatet e rezolutave që do të adoptohen nga Këshillat respektive të Guvernatorëve të Fondit, Bankës, Korporatës dhe Shoqatës dhe të Këshillit të Drejtuesve të Agjencisë në lidhje me anëtarësinë e Republikës së Shqipërisë në këto organizata.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë është gjithashtu e autorizuar të nënshkruajë dhe ratifikojë në emër të Republikës së Shqipërisë konventën e zgjidhjes së konflikteve në investimet midis shtetit dhe shtetasve të huaj (konventa ICSID) teksti i të cilës jepet në aneksin VI të këtij ligji.

Ministria e Financave, ose ndonjë person tjetër i caktuar prej Tij, autorizohet këtu të nënshkruajë origjinalet e neneve të Marrëveshjes së Fondit, Bankës, Korporatës dhe Shoqatës Konventës themeluese të Agjencisë dhe Konventën e ICSID dhe të ekzekutojë dhe depozitojë çdo instrument të pranimit dhe dokumentet e tjera që mund të kërkohen për këtë qëllim.

Me pranimin e Republikës së Shqipërisë si anëtare e Fondit, Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar dhe i udhëzuar në emër të Republikës së Shqipërisë të pranojë Amendamentin e III të propozuar të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar, teksti i të cilit jepet në aneksin VII të këtij ligji dhe që do të përfshihet në nenet e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Neni 2

Me pranimin e Republikës së Shqipërisë si anëtare e Fondit Qeveria e Republikës së Shqipërisë është këtu e autorizuar dhe udhëzuar të pranojë pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale të Fondit, dhe Ministri i Financave autorizohet këtu të ekzekutojë dhe depozitojë në Fond, në emër të Republikës së Shqipërisë, një Instrument të pjesëmarrjes ku të deklarohet se Republika e Shqipërisë merr përsipër të gjitha detyrimet e një pjesëmarrësi në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale të Fondit, në përputhje me ligjin e Republikës së Shqipërisë dhe të thuhet që Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të bërë të mundur përmbushjen e të gjitha detyrimeve të një pjesëmarrësi në

Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale të Fondit.

Neni 3

a) Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar autorizohet dhe udhëzohet të marrë hua ose të sigurojë me mjete të përshtatshme dhe të paguajë në emër të Republikës së Shqipërisë shumat që herë pas here duhet t'i paguhen Fondit, Bankës, Korporatës, Shoqatës dhe Agjencisë sipas kushteve dhe afateve të Rezolutave që rrjedhin nga anëtarësia e Republikës së Shqipërisë në organizatat sipas neneve respektive të Marrëveshjeve ose Konventës, dhe për të bërë pagesa në lidhje me pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale të Fondit.

b) Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit Shqiptar autorizohet këtu të emërtojë në përputhje me nenet e Marrëveshjes së Fondit, Bankës, Korporatës e Shoqatës dhe të Konventës Themeluese të Agjencisë, letra me vlerë të patregtueshme dhe pa interes që mund të jenë të nevojshme ose të përshtatshme lidhur me anëtarësinë e Republikës së Shqipërisë në Fond, në Bankë, në Shoqatë, Korporatë ose Agjenci.

Neni 4

a) Banka e Shtetit Shqiptar do të shërbej si agjenci fiskale e Republikës së Shqipërisë siç kërkohet në nenin V, seksioni i I i Marrëveshjes së Fondit dhe nenin III, seksioni "i Marrëveshjes së Bankës dhe është autorizuar që, në emër të Republikës së Shqipërisë, të kryejë të gjitha operacionet dhe transaksionet e autorizuara sipas dispozitave të ndryshme të neneve të Marrëveshjes së Fondit dhe Bankës, Banka e Shtetit Shqiptar është caktuar si kanali komunikues referuar nenit IV, seksioni i 10 i neneve të Marrëveshjes së Korporatës, neni 2 i seksionit 10 i Marrëveshjes së Shoqatës dhe nenit 38 të Konventës Themeluese të Agjencisë.

b) Banka e Shtetit Shqiptar do të shërbejë si depozituese në Republikën e Shqipërisë për mbajtjen e fondeve monetare të Fondit, Bankës, Korporatës, Shoqatës dhe Agjencisë dhe për këtë arsye autorizohet të kryejë në emër të Republikës së Shqipërisë, të gjitha operacionet dhe transaksionet e autorizuara sipas instrumenteve të ndryshme kontabile të adaptuara nga Fondi ose Banka.

Neni 5

Nenet e Marrëveshjes së Fondit, Bankës, Korporatës dhe Shoqatës dhe të Konventave Themeluese të Agjencisë dhe Konventës së ICSID do të kenë fuqi dhe efekt të plotë në Republikën e Shqipërisë nga data respektive të pranimit të Republikës së Shqipërisë si anëtare në këto organizata.

Neni 6

Banka e Shtetit Shqiptar autorizohet të marrë në emër të Republikës së Shqipërisë, çdo shumë që mund të paguhet ose të transferohet në Republikën e Shqipërisë në operacionet dhe transaksionet e autorizuara sipas dispozitave të ndryshme të neneve të Marrëveshjes së Fondit dhe të Bankës.

Neni 7

Kur është e domosdoshme, Ministri i Financave do të nxjerrë udhëzime ose rregulla në zbatim të dispozitave të këtij ligji në mënyrë që të përmbushen detyrimet e Republikës së Shqipërisë sipas neneve të ndryshme të Marrëveshjes, Konventave dhe Rezolutave që i referohen nenit 1 me sipër.

Neni 8

Veprimtaria e Këshillit të Ministrave dhe organizmave të tjera shtetërore në marrëdhënie me këto organizma ndërkombëtare do t'i nënshtrohet kontrollit periodik të Kuvendit Popullor.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.44 datë 2.10.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia